



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe neneve 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 05. 09.2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR
VENDOSJEN E TRAFOSTACIONIT DISTRIBUTIV NË LIPJAN**

Neni 1

Ipet në shfrytëzim toka-Pasuri Shoqërore KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Ferizaj për vendosjen e TS-it me fuqi 630kVA të tipit Blindë me sipërfaqe prej 15m² në pjesën e parcelës kadastrale:

P-71409044-01493-1 në vendin e quajtur "Voqnjaci" me sipërfaqe prej 1953m² e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme Nr.4714/2016 ZK Lipjan, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Pjesa e parcelës kadastrale me sipërfaqe prej 15m² e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, ipet në shfrytëzim për periudhën prej 99 viteve KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Ferizaj, për vendosjen e TS-it me fuqi 630kVA konformë kushteve që janë caktuar me Pëlqimin e Drejtoratit për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Nr.8-351-56152 të datës 30.03.2016, me qëllim të përmirësimit të rrjetit elektrik dhe furnizimit më të mirë me energji elektrike në qytetin e Lipjanit.

Neni 3

Shfrytëzuesi KEDS, obligohet që pas plotëfuqishmërisë së këtij vendimi dhe para vendosjes së trafostacionit në pjesën e parcelës 01493-1 e dedikuar për këtë qëllim, të pajiset me lejen urbanistike në mënyrë që vendosja e saj të mos bie ndesh me Planet Urbanistike dhe Planet Zhvillimore të Komunës.

Neni 4

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta bënë parcelializimin e sipërfaqës e cila ipet në shfrytëzim dhe e njëjta të regjistrohet në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë për 99 vite Kompanisë KEDS.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

15Nr. 464 - 49781

Lipjan, më 06. 09. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

